



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2021:239100
Datë: 16.02.2024
Numri i dokumentit: 05342319

KPPP.nr. 1954/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, gjyqtari Florent Zeqiri, në çështjen përmbartimore të kreditorit “F-Shped” me seli në Prishtinë, Dardani, rr. “Lekë Dukagjini” që sipas autorizimit përfaqësohet nga avokat L.M. me zyre në Ferizaj, kundër debitorit “Eneritech” Sh.P.K., me seli në Prishtinë, rr. “Nail Hyseni” nr. 22, që sipas autorizimit përfaqësohet nga avokat A.K. dhe A.F. me zyre në Prishtinë, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr. 558/21 të datës 20.09.2021, të lejuar nga Përmbartuesi Privat Besnik H. Aliu me zyre në Ferizaj, jashtë seancës me datë 16.02.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. REFUZOHET në tërësi si i pabazuar prapësimi i debitorit “Eneritech” Sh.P.K., ndërsa Urdhri Përmbartimor P.nr. 558/21 i datës 20.09.2021, i lejuar nga Përmbartuesi Privat Besnik H. Aliu me zyre në Ferizaj, MBETET NË FUQI.
- II. OBLIGOHET debitori që në emër të shpenzimeve për përpilimin e përgjigjes në prapësim, t’ia paguaj kreditorit shumën prej EUR 78.00 (me shkronja: shtatëdhjetë e tetë euro) në afat prej shtatë (7) ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktvendimi.

A r s y e t i m

Përmbartuesi Privat Besnik H. Aliu me seli në Ferizaj, duke vepruar sipas propozimit për përmbartim të kreditorit “F-Shped”, ka lëshuar urdhrin P.nr. 558/21 të datës 20.09.2021 me të cilin ka lejuar përmbartimin në baze të dokumenteve të besueshme - faturave si në vijim: faturës me nr. R37068 e datës 22.05.2021; faturës me nr. R36936 e datës 22.05.2021; faturës me nr.

R36905, e datës 22.05.2021; faturës me nr. R37429 e datës 24.05.2021; faturës me nr. R37411 e datës 24.05.2021 si dhe faturës me nr. R37393 e datës 24.05.2021, duke detyruar debitorin, në emër të borxhit sipas faturave të lartcekura, ta paguaj detyrimin në vlerë totale prej 540.00 EUR (me shkronja: pesëqind e katër dhjetë euro), me kamatë ligjore prej 8% nga dita e lëshimit të faturave e deri në pagesën definitive, si dhe shpenzimet e procedurës përmbartimore.

Kundër urdhrorit për lejimin e përmbartimit, ne afatin ligjor prapësim ka paraqitur debitori duke ka theksuar se dokumenti me te cilin është marre vendimi përmbartues nuk është dokument i besueshëm ngase i mungon baza ligjore dhe është me kundërshtim me nenin 4 te këtij ligji. Me tutje, ka theksuar se urdhri përmbartimor është marr ne kundërshtim me nenin 38 te LPP-se, ngase debitori nuk i ka nënshkruar faturat, dhe ne fature mungon afati për përmbushje vullnetare. Po ashtu, ka theksuar se urdhri është marre ne kundërshtim edhe me nenin 27 te LPP-së, dhe se faturat asnjëherë nuk i janë dorëzuar nga ana e kreditorit, por kreditori e ka keqpërdorur vulën e debitorit për te cilën ka qene i kontraktuar te bej vulosjen e dokumentacionit për eksport te mallit, dhe ne te njëjtën kohe ka bërë vulosjen e faturave. Ne fund, gjykatës i ka propozuar që te aprovohet prapësimi i debitorit "Entertech SH.P.K dhe te anulohet urdhri për përmbartim P.nr.558/2021, i datës 20.09.2021.

Kreditori, brenda afati ligjor, ka paraqitur përgjigje ne prapsim, me ' rast ka theksuar se faturat janë dokumente te besueshme dhe se te njëjtat janë pranuar ne mënyrë të rregullt nga debitori. Gjykatës i ka propozuar qe te refuzohet prapësimi dhe te mbetet ne fugi urdhri.

Gjykata Themelore në Prishtinë, me aktvendimin PPP.nr 1205/2021 të datës 30.12.2021 ka aprovuar si të bazuar prapësimin e debitorit të ushtruar ndaj urdhrorit për lejimin e përmbartimit P.nr. 558/2021 të datës 20.09.2021 të lejuar nga Përmbartuesi Privat H. Aliu.

Gjykata Komerciale e Kosovës – Dhomat e Shkallës së Dytë, me aktvendimin K.DH.SH.II.nr. 267/23 të datës 02.10.2023 ka aprovuar ankesën e kreditorit si të bazuar ashtu që ka anuluar aktvendimin PPP.nr 1205/2021 të datës 30.12.2021 të lëshuar nga Gjykata Themelore në Prishtinë dhe lëndën e ka kthyer në rivendosje në shkallë të parë pranë Gjykatës Komerciale – Dhomat e Shkallës së Parë.

Gjykata, në rivendosje, pas shqyrtimit të pretendimeve të palëve ndërgjyqëse dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, si dhe duke marrë për bazë vërejtjet e dhëna nga Dhomat e shkallës së dytë të kësaj gjykate përmes aktvendimit K.DH.SH.II.nr. 267/23 të datës

02.10.2023, në mbështetje të nenit 69 dhe 71 të Ligjit Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbartimore (tutje si LPP), gjeti se prapësimi i debitorit është i pabazuar për shkaqet si në vijim:

Sipas nenit 29 par.1 të LPP-së, përcaktohet se *“Përmbartimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”*, ndërsa me nën-par.1.3 të këtij neni fatura përcaktohet si një nga dokumentet e besueshme, kurse me neni 29 par. 3 të LPP-së, përcaktohet se *“Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbartim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar”*, dhe me nenin 37 të LPP-së, përcaktohet se *“Kur propozimi për përmbartim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t’i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit.”*.

Gjykata në rastin konkret vlerëson urdhri përmbartimor P.nr. 558/2021 i datës 20.09.2021 është lejuar mbi bazën e faturave nr. R37068 e datës 22.05.2021; faturës me nr. R36936 e datës 22.05.2021; faturës me nr. R36905, e datës 22.05.2021; faturës me nr. R37429 e datës 24.05.2021; faturës me nr. R37411 e datës 24.05.2021 si dhe faturës me nr. R37393 e datës 24.05.2021 nr. 121/2018 të datës 07.11.2018 të cilat i plotësojnë kushtet për të qenë dokumente të besueshme dhe i përmbajnë të gjitha elementet e kërkuara në përputhje me nenin 29.3 të LPP-së, kjo pasi që në secilën faturë janë treguar palët, përkatësisht kreditori dhe debitori, janë të përshkruara qartë shërbimet të cilat kanë qenë objekt i faturave është përcaktuar shuma e cila është detyrim për përmbushje nga ana e debitorit si dhe koha e përmbushjes së këtij detyrimi.

Po ashtu faturat e lartcekura i janë bashkëngjitur propozimit për përmbartim në origjinal, në përputhje me nenin 37 të LPP-së, dhe të njëjtat janë pranuar me rregull nga debitori, e si të tilla janë të përshtatshme për përmbartim dhe paraqesin bazë për lejimin e përmbartimit.

Gjykata vlerësoi pretendimet e debitorit se urdhri për përmbartim nuk është i rregullt dhe nuk i plotëson kërkesat e nenit 38 paragrafi 1 dhe 2 të LPP-së, sipas të cilit propozimi për përmbartim duhet të ketë edhe nënshkrimin e faturës së pranuar, mirëpo gjeti se të njëjtat janë të pabazuara për faktin se secila nga faturat në bazë të së cilave është lejuar përmbartimi mbajnë vulën e debitorit tek pranuesi faturës, çka dëshmon faktin se debitori ka qenë në dijeni lidhur me faturat në fjalë, dhe të njëjtat asnjëherë nuk i ka kundërshtuar, andaj fakti se faturat e lartcekura nuk përmbajnë nënshkrim të debitorit nuk i bën të njëjtat të papërshtatshme për përmbartim.

Gjykata po ashtu vlerësoi pretendimet e debitorit se propozimi për përmbardim nuk përmban datën e përmbushjes vullnetare të detyrimit dhe gjeti se të njëjtat nuk gjejnë mbështetje ligjore sepse afati i përmbushjes së detyrimit është përcaktuar në faturë dhe i emërtuar si “datë e skadimit të faturës” e po ashtu afati vullnetar për pagesë është përcaktuar edhe propozimin për përmbardim, ashtu siç kërkohet me dispozitën e nenit 40 par 1.2 të LPP-së, i cili përcakton se: *“1.Propozimi për përmbardim në bazë të dokumentit të besueshëm duhet të përmbajë:... kërkesën që organi përmbardues ta detyrojë debitorin e përmbardimit që brenda afatit prej shtatë (7) ditësh, kurse në kontestet nga raportet ku ekziston kambiali dhe çeku brenda afatit prej tre (3) ditësh, nga dita në të cilën i dorëzohet aktvendimi ta përmbushë detyrimin bashkë me shpenzimet e caktuara...”*.

Gjykata po ashtu pati parasysh pretendimet debitorit se kreditori ka keqpërdorur vulën e biznesit të debitorit, pasi që i njëjti ka qenë i autorizuar që këtë vulë ta përdor vetëm për vulosjen e dokumentacionit për eksport të mallit, por jo edhe të faturave objekt i këtij përmbardimi, por që përveç deklarimeve të tilla, debitori nuk ka ofruar asnjë provë ashtu siç kërkohet me nenin 69 par.4 të LPP-së për të dëshmuar faktin se kreditori ka ndërmarrë veprime të tilla të paautorizuara, apo se ndaj këtij të fundit është iniciuar ndonjë procedurë gjyqësore penale lidhur me këto keqpërdorime të pretenduara.

Rrjedhimisht, në mungesë të provave që dëshmojnë ekzistimin e një prej bazave për mbështetje të prapësimi nga neni 71 i LPP-së, gjykata u kufizua vetëm në vlerësimin e aspektit formal të faturave objekt i këtij përmbardimi, e të cilat fatura rezultojnë të jenë të përshtatshme për përmbardim, andaj edhe u vendos që prapësimi i debitorit të refuzohet.

Sa i përket shpenzimeve të procedurës përmbardimore, gjykata ka vendosur në kuptim të nenit 17 dhe 13 të LPP-së, duke ia njohur kreditorit shpenzimet për përpilimin e përgjigjes në prapësim në shumën prej 78.00 €, siç është e përcaktuar me Rregulloren e OAK-së e datës 18.03.2017 nr. tarifor gjashtë (6), lidhur me parashtrësat përmbardimet në bazë të dokumentit të besueshëm me vlerë deri në lartësinë e kontestit të vlerës së vogël, kjo meqenëse përgjigja në prapësim nuk paraqet mjet juridik por parashtrësë, ndërsa vlera e kontestit në rastin konkret është në shumë prej 540.00 EUR, që hyn në kuadër të kontesteve me vlerë të vogël.

Nga sa u tha më lart, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi, duke u bazuar në nenin 64 par.4, nenin 71 dhe nenin 73 të LPP-së, si dhe nenin 13 par.1 nën par. 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr. 1954/23, datë 16.02.2024

Gjyqtari

Florent Zeqiri

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimi të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.